Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/1018

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga;Isa Hasani-Kryetar, Vedat Poterqoi-Anëtar dhe Vjosa Gradinaj-Mexhuani- Anëtare duke vendosur sipas ankesës së OE "Alkaloid", kundër Njoftimit për kontratë ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me material për Hemodializë nga LE për SHSKUK" me numër të prokurimit 00220-23-12480-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) Shërbimi Spitalor Klinik Universitare i Kosovës, më 21/02/2024, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet si pjesërisht e bazuar ankesa e Operatorit ekonomik "Alkaloid" me nr. 2023/1018, e datës 15/12/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me material për Hemodializë nga LE për SHSKUK", për Lot 1 dhe Lot 3, me numër të prokurimit: 00220-23-12480-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti kontraktues (AK) Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës.

2. Mbetet në fuqi, Dosja e Tenderit/ B05-Njoftimi për Kontratë, i datës,10.11.2023, me korrigjim të gabimeve-Formulari B54-sistemi e-prokurim, datës 29.11.2023 dhe 6.12.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me material për Hemodializë nga LE për SHSKUK", për Lot 1 dhe Lot 3, me numër të prokurimit 00220-23-12480-1-1-1.

3. Lejohet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës OE ankues, sipas nenit 31.4 dhe obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 10.11.2023, Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Furnizim me material për Hemodializë nga LE për SHSKUK", me numër të prokurimit 00220-23-12480-1-1-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: LOT 1- 216,138.00 € dhe LOT 3- 2,034,350.00€.

Me 05.12.2023 OE "Alkaloid" ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 05.12.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me datën 15.12.2023, OE "Alkaloid", ka parashtruar ankesë me nr: 2023/1018, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me material për Hemodialize nga LE për SHSKUK" LOT 1 dhe 3 me nr. të prokurimit "00220-23-12480-1-1-1"

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Përgjigjja, më 06.12.2023, e Autoritetit Kontraktues-Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës, Refuzohet, Kërkesa për Rishqyrtim e Operatorit ekonomik ankues" Alkaloid".

Arsyetim: Autoriteti Kontraktues ka zhvilluar aktivitetin e prokurimit të lartë cekur sipas LPP-së, në përputhje me dispozitat e ligjit ne fuqi dhe kërkesës nga njësia kërkuese për inicimin e procedurës së prokurimit ashtu siç është e përshkruar në LE .

AK ka pranuar përgjigjje për këtë kërkes nga njesia kërkuese si më poshtë :

Në bazë të vendimit nr 124/VIII/2023 i dates 21.08.2023 me nr. protokolli 05-5106 të nxjerr nga Ministria e shendetsisie me te cilin plotesohet dhe ndryshohet lista esenciale e aprovuar me vendim nr 87/V/2023 me Nr protokolli 05-3113 te dates 22.05.2023 .

Ku ne ket vendim eshte e percaktuar si specifik per dializatoret te jane me sterilizim me avull (steam High Flux polysulfone dializer haemadiafilter),steam sterilization (gjeni te bashkangjitur vendimin se bashku me listen esenciale.

Ne Listen esenciale te aprovuar ne gusht te vitit 2023 dhe Nentor te vitit 2023 metoda e sterilizimit eshte Steam sterilization (pra sterilizim me avull).

Përfundim: Në bazë të arsyeve të lartcekura Autoriteti Kontraktuesi SHSKUK-së e refuzon këtë kërkesë për rishqyrtim si të **pa bazuar.**

Për ne të gjithë Operatoret Ekonomik janë të rendësishëm dhe të barabartë.

Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtroj ankesë pranë OSHP-së.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Alkaloid" janë parashtruar si në vijim:

"Njësia e kërkesës- Shkel Nenin 7 dhe 28 te LPP-se (Specifikime teknike favorizuese) Përpilimi i specifikimeve teknike te detyrueshme nga njësia e kërkesës për llot 1 artikujt LOT 1 dhe LOT 3, përkatësisht pretendimi i EO ankues citat:" Tek Aneksi 1 ne DT - Specifikimet teknike te detyrueshme ne Lot 1 dhe Lot 3 keni përshkruar produktet qe pretendoni ti prokuroni duke cekur se produktet qe mund te ofrohen duhet te jeni "Steam Sterilisation" me Sterilizim me avull kështu duke eliminuar te gjitha metodat tjera te sterilizimit sikur ato me sterilizim me Dry Heat, Gamma sterilizim dhe E-Beam Sterilizim, kështu duke kufizuar konkurrencën dhe duke favorizuar vetëm prodhues qe prodhojnë Dializatore me Steam Sterilizaton e qe numri i tyre është shume i vogël ne krahasim me prodhues te njohur botërore për prodhimin e Dializatoreve me Sterilizim Gamma siç janë: B Braun, Nipro, Nikkiso, Asahi Kasy etj, kështu duke shkelur Nenin 28 te LPP - Specifikimet Teknike. Arsyetimi i AK-SHSKUK se për hartimin e specifikimeve teknike janë bazuar ne Listën Esenciale nuk qëndrojnë për arsyeje se ky specifikim ne LE është qe nga viti 2003 dhe është i përshtatur specifikimeve te vetëm një kompanie Fresenius Medical Care e cila ka pasur monopol deri ne vitin 2017, kur pas ankesave është ndryshuar specifikimi teknik për Dializatore qe ka mundësuar pjesëmarrje me te gjere te ofertuesve me prodhues te ndryshëm me çfarë edhe janë lidhur edhe kontrata me çmime shume me te ultë për shërbime te njëjta. Për te vërtetuar qe AK-SHSKUK nuk i është referuar Listës Esenciale gjate përpunimit te DT ne te njëjtat Lote koeficienti i Ultrafiltrimit është kërkuar me e madhe ose e barabartë me 40 për Lot 1 dhe me e madhe ose e barabartë me 50 për Lot 3 gjë qe nuk është ne përputhje me Listën Esenciale ku për produktin qe kërkohet për Lot 1 koeficienti i Ultrafiltrimit është 50 ndërsa për Lot 3 ky koeficient ne LE është 55.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 28.12.2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1018/2023, ndërsa me datë 05.01.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2023/1018 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, ekspertja shqyrtuese dhe teknike i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Vlerësimi i eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/1018, të pretendimeve ankimore të OE ankues, si në vijim;

Ekspertja teknike pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, sa i përket specifikimeve teknike për LOT 1 dhe LOT 3, ekzistojnë dy vendime të listës esenciale të barnave (LEB): 1. LEB Vendimi i MSH datë 22/05/23, nr. protokolli 05-3113, në tabelën Hemodialyses Materials, tek specifikimi llojit CAPILLARY DIALYSER, përveç Steam Sterilization figuron edhe Gamma Rays (1.6 dhe 1.8). 2. Përderisa, në LEB Vendimi i MSH i datës 21/08/23, plotësim ndryshim i vendimit, nr. protokolli 05-5106, në tabelën Hemodialyses Materials, tek specifikimi llojit Capillary Dialyser është vetëm Steam Sterilization dmth është larguar Gamma Rays (1.6

dhe 1.8).

Po ashtu, vlen të theksohet se specifikat teknike të detyrueshme nga AK për koeficientet e ultrafiltrimit për LOT 1 është kërkuar të jetë më e madhe ose e barabartë se 40, ndërsa për LOT 3 është kërkuar të jetë më e madhe ose e barabartë se 50. Ku kjo kërkesë për të dy LOT-et 1 dhe 3 bie në kundërshti me LEB, pasi aty koeficienti i ultrafiltrimit për LOT 1 është 50, ndërsa për LOT 3 është 55. Si përfundim, Vendimi i MSH për LEB, Datë 22/05/23, nr. protokolli 05-3113 lejon ekuivalencë /hapësirë për OE; përderisa Vendimi i MSH për LEB, i datës 21/08/23, plotësim ndryshim i vendimit nr. protokolli 05-5106, kufizon numrin e aplikimeve të OE, andaj përderisa AK tek koeficienti i ultrafiltrimit lejon ekuivalencë, e cila në LEB është e kufizuar, atëherë si e tillë, konsideroj se edhe pjesa e sterilizimit me avull të lejohet hapësira që të ofrohet edhe me metodat E-Beam Sterilizim, Dry Heat, dhe Gamma, për faktin se e zgjeron konkurrencën dhe respekton nenin 7 të LPP-së. Si e tillë, sipas sqarimeve më lartë, ekspertja teknike rekomandon që për specifikat teknike për LOT 1 dhe 3 të aprovohet ankesa e OE ankues.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se nuk pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertin shqyrtuese, ndërsa OE është pajtuar me raportin e ekspertit.

- *Gjetjet e Panelit Shqyrtues –*

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në ketë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e Operatorit ekonomik ankues, raporti është bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit, përmes dosjes së tenderit. Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues të cilat janë vlerësuar sipas raportit të ekspertit, vëren se eksperti shqyrtues i ka identifikuar aktet ligjore mbi bazën e te cilave dhe janë vendosur kriteret ne dosjen e tenderit, ku sqarohet, sa i përket specifikimeve teknike për LOT 1 dhe LOT 3, ekzistojnë dy vendime të listës esenciale të barnave (LEB): 1. LEB Vendimi i MSH datë 22/05/23, nr. protokolli 05-3113, në tabelën Hemodialyses Materials, tek specifikimi llojit CAPILLARY DIALYSER, përveç Steam Sterilization figuron edhe Gamma Rays (1.6 dhe 1.8). 2. Përderisa, në LEB Vendimi i MSH i datës 21/08/23, plotësim ndryshim i vendimit, nr. protokolli 05-5106, në tabelën Hemodialyses Materials, tek specifikimi llojit Capillary Dialyser është vetëm Steam Sterilization dmth është larguar Gamma Rays (1.6 dhe 1.8). Dhe për ketë konsiderohet ankesa pjesërisht e bazuar, por rekomandimi përfundimtarë, nuk përkon me legjislacionin që rregullon çështjen në fjalë, e të cilin duhet ta zbatojnë SHSKUK.

Paneli konstaton se Vendimi i MSH datë 22/05/23, nr. protokolli 05-3113, ka përcaktuar dy mënyrat e sterilizimit, por qe ky vendim është ndryshuar me Vendimin e MSH i datës 21/08/23, plotësim ndryshim i vendimit, nr. protokolli 05-5106, ka përcaktuar mënyrat tjera të sterilizimit sipas Listës esenciale te barnave (LEB) për nivelin primar, sekondar dhe terciar që mbulohen nga buxheti mi Republikës se Kosovës, te cilin vendim e ka zbatuar SHKSUK, me rastin e Dosjes se tenderit dhe OE ankues nuk ka pasur njohuri për këto ndryshime ligjore.

Me neni 59- Shërbimet e kujdesit shëndetësor themelor me Ligji Nr. 04/L-125 Për Shëndetësi, ka përcaktuar se Ministria e Shëndetësisë, përcakton Listën e shërbimeve të përpiluar nga komiteti teknik i emëruar nga Ministri i Shëndetësisë në fillim të çdo viti fiskal; të miratuar nga Qeveria, në pajtim me resurset financiare në dispozicion dhe nevojat shëndetësore të popullatës. Po ashtu neni,1.19. Lista e shërbimeve të kujdesit shëndetësor – përcakton se ,Lista e formave dhe llojeve të shërbimeve të kujdesit shëndetësor që mbulohen nga Qeveria dhe nga bashkë-pagesat 3 (përfshirë Listën e produkteve mjekësore dhe materialeve shpenzuese) e cila përpilohet nga komiteti teknik i emëruar nga Ministri i Shëndetësisë. Lista mund të modifikohet sipas nevojës në bazë të vlerësimit të Ministrisë.

Neni 62 Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës përbëhet nga institucionet e nivelit dytësor dhe tretësor të kujdesit shëndetësor në sektorin publik të shëndetësisë, të përcaktuara me aktin nën-ligjor të nxjerr nga Ministria, në pajtim me këtë ligj dhe me përgjegjësi të veçanta për zbatim të këtij ligji dhe akteve nën-ligjore të nxjerra nga Ministria.

Paneli shqyrtues konstaton se, AK në ketë aktiviteti prokurimi me rastin e hartimit te kritereve te Dosjes se tenderit vetëm ka zbatua ligjin përkatësisht, Vendimin e MSH i datës 21/08/23, plotësim ndryshim i vendimit, nr. protokolli 05-5106, i cili ka përcaktuar mënyrat tjera të sterilizimit sipas Listës esenciale te barnave (LEB) për nivelin primar, sekondar dhe terciar që mbulohen nga buxheti mi Republikës se Kosovës. Paneli konstaton se ankuesi nuk ka arritur të dëshmoj me prova konkrete se ka pasur shkelje ligjore përkatësisht kritere diskriminuese në Dosjen e tenderit nga ana e Autoritetit Kontraktues gjatë zhvillimit të aktivitetit të prokurimit.

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik, Ligjit Nr. 04/L-125 Për Shëndetësi dhe vendimit te MSH, për kërkesat e Dosjes së tenderit, lidhur me aktivitetin e prokurimit, me numër të prokurimit: 00220-23-12480-1-1-1 " andaj Paneli Shqyrtues ka vendosur që të Mbetet në fuqi, Dosja e Tenderit/

B05-Njoftimi për Kontratë, i datës,10.11.2023, me korrigjim të gabimeve-Formulari B54-sistemi e-prokurim, datës 29.11.2023 dhe 6.12.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me material për Hemodializë nga LE për SHSKUK", për Lot 1 dhe Lot 3, me numër të prokurimit 00220-23-12480-1-1-1.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, dhe nenin 105 nenin të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendi mi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **SHSKUK - SHËRBIMI SPITALOR KLINIK UNIVERZITARE I KOSOVËS**
- OE - **Alkaloid**
- Arkivës së OSHP-së: